



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 73

Tiranë – E enjte, 4 maj 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 4.5.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rruga e re e varrezave Elbasan dhe ndërtimi i nënkalimit hekurudhor në kryqëzimin e rrugës nacionale Elbasan–Librazhd me rrugën ‘Borodin Mitarja’ dhe ‘Rikonstruksion dhe ndërhyrje në linjën KUZ, ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezave publike dhe zgjerimi i varrezave publike’”, Bashkia Elbasan.....	8479
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 272, datë 4.5.2023	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier, nga shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k.....	8481
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 4.5.2023	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria “Renew Power Albania” sh.p.k.....	8484
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 274, datë 4.5.2023	Për përcaktimin e kategorive të tjera të ndërtesave që përjashtohen nga ligji nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë në ndërtesa”..	8486
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 275, datë 4.5.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës ‘Tasi Dëma’, Fier”.....	8492
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 276, datë 4.5.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall”, të ndryshuar.....	8493

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 4.5.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore”, të ndryshuar.....	8494
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 278, datë 4.5.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave”, të ndryshuar.....	8494
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 279, datë 4.5.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e hartimit të projekteve për miratimin e lejeve të ndërtimit, për ndërtimin e njësisë të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në Bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Mirditë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë”, të ndryshuar.....	8495
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 280, datë 4.5.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim të detyruar”, të ndryshuar.....	8496
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 4.5.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 543, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë nr. 1/644, zona kadastrale nr. 8210, Tiranë, në Administrim të Ministrisë së Drejtësisë dhe kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Bashkia Tiranë tek Ministria e Drejtësisë, të pasurisë nr. 5/626, zona kadastrale nr. 8160, Tiranë, si dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 7.8.2013, dhe nr. 219, datë 21.3.2017”, të ndryshuar.....	8496
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 282, datë 4.5.2023	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar.....	8498

**VENDIM****Nr. 271, datë 4.5.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RRUGA E RE E
VARREZAVE ELBASAN DHE NDËRTIMI
I NËNKALIMIT HEKURUDHOR NË
KRYQËZIMIN E RRUGËS NACIONALE
ELBASAN-LIBRAZHD ME RRUGËN
‘BORODIN MITARJA’ DHE
‘RIKONSTRUKSION DHE NDËRHYRJE
NË LINJËN KUZ, NDËRTIMI I SHESHIT
TË PARKIMIT TË VARREZAVE PUBLIKE
DHE ZGJERIMI I VARREZAVE
PUBLIKE’”, BASHKIA ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rruga e re e varrezave Elbasan dhe ndërtimi i nënkalimit hekurudhor në kryqëzimin e rrugës nacionale Elbasan-Librazhd me rrugën ‘Borodin Mitarja’ dhe ‘Rikonstrukcion dhe ndërhyrje në linjën KUZ, ndërtimi i sheshit të parkimit të varrezave publike dhe zgjerimi i varrezave publike’”, Bashkia Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 303 354 (nëntë milionë e treqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 303 354 (nëntë milionë e treqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e katër) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LISTA E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RRUGA E RE E VARREZAVE ELBASAN DHE NDËRTIMI I NËNKALIMIT HEKURUDHOR NË KRYQËZIMIN E RRUGËS NACIONALE ELBASAN–LIBRAZHD ME RRUGËN ‘BORODIN MITARJA’ DHE ‘RIKONSTRUKSION DHE NDËRHYRJE NË LINJËN KUZ, NDËRTIMI I SHESHIT TË PARKIMIT TË VARREZAVE PUBLIKE DHE ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE’”, BASHKIA ELBASAN

NR.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							TË DHËNAT E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN				(KUFIZIME HIPOTEKARE)
											ARË			VLERA TOTALE (lek)	
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	VLERA TOTALE (lek)	
1	Lindita	Ibrahim	Myzyri	Elbasan	8522	18/24	Arë	13200	9	147	9,722	222	2,158,284	2,158,284	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Jonaid	Abdyl	Myzyri												
	Hatixhe	Adem	Zenelhxha												
	Aida	Adem	Kacollja												
	Gazmend	Adem	Zenelhxha												
	Ymer	Kadri	Myzyri												
	Sokol	Kadri	Myzyri												
	Irma	Naim	Haxhihseni												
	Adile	Naim	Çelirama												
	Zvjetlana	Ali	Garunja												
	Zhuljeta	Ali	Zhika												
	Haki	Ali	Kotherja												
Edmonda	Ali	Pepa													
Ilirjan	Ali	Kotherja													
2	Osman	Haxhi	Fejzo	Elbasan	8522	18/4	Arë	8000	9	134	4,938	222	1,096,236	1,096,236	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Xhaferr	Mustafa	Karadaku	Elbasan	8522	18/2	Arë	1200	9	135	155	222	34,410	34,410	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Ruzhdie		Peza												
	Zyba		Osmanaj												
4	Abdyl	Ibrahim	Qatipi	Elbasan	8522	18/1	Arë	6000	9	130	2,910	222	646,020	646,020	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Emin		Kacadei	Elbasan	8522	18/25	Arë	8000	9	149	8,000	222	1,776,000	1,776,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Abdurraman	Mehmet	Beluli	Elbasan	8522	18/23	Arë	8000	9	146	8,000	222	1,776,000	1,776,000	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Nada	Ali	Skikuli	Elbasan	8522	18/157	Arë	8182	33	232	8,182	222	1,816,404	1,816,404	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Agron	Skender	Haxhihseni												
	Eduart	Skender	Haxhihseni												
	Mamica	Sokol	Grabocka												
	Rezarta	Sokol	Grabocka												
	Tajar	Ali	Qerfozi												
VLERA TOTALE											41,907		9,303,354	9,303,354	



VENDIM
Nr. 272, datë 4.5.2023

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË
CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE
FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE
NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË
OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN
KADASTRALE NR. 1020, FSHATI
ALLPRENAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE
GOLEM, BASHKIA LUSHNJË, QARKU
FIER, NGA SHOQËRIA “5GX ENERGY”
SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier, nga shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal, NIPT/NUIS: M27511801Q;

c) Tipi centralit: Fotovoltaike;

ç) Kapaciteti i instaluar: 10 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të parkut fotovoltaike do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaike;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penaltetet në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.



2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKSI 1

Koordinatat e Centralit Elektrik Fotovoltaik					
Në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë,					
Qarku Fier					
Shoqëria “5GX ENERGY” sh.p.k.					
Nr.	E	N	Nr.	E	N
1	474417.65	4536806.74	11	474646.77	4536581.09
2	474504.84	4536811.43	12	474582.15	4536531.84
3	474594.1	4536845.71	13	474466.88	4536629.3
4	474635.16	4536807.02	14	474484.19	4536704.85
5	474649.08	4536842.31	15	474457.12	4536739.07
6	474784.65	4536777.84	16	474427.69	4536786.41
7	474747.42	4536612.61	17	474589.49	4536748.26
8	474770.98	4536568.32	18	474594.79	436756.54
9	474745.59	4536513.14	19	474523.79	4536785.6
10	474658.29	4536572.2	20	474420.31	4536797.54



PLAN VENDOSJE

OBJEKTI: "5GX ENERGY SOL PARK, 10MW"

VENDODHJA: Zona Kadastrale 1020, Fshati Alliprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier, Shqipëri.

ZHVILLUESI: Shoqëria "5GX ENERGY" sh.p.k


HARTOI: DELTA PLAN STUDIO
LICENCE N.7039, Ing Elektrik Entela PONARI

NUMRAT E PASURIS

1	169 /46
2	169 /49
3	169 /51
4	170 /16
5	173 /12



KRGJSH



SHKALLA 1:25000

Sipërfaqe 75881m²Entela
PonariPavlina
Qosja

KORDINATAT NE KRGJSH

Nr	E	N	Nr	E	N	Nr	E	N
1	474417.65	4536806.74	7	474787.42	4536612.61	14	474484.19	4536704.85
2	474504.84	4536811.43	8	474775.98	4536508.32	15	474457.72	4536739.07
3	474504.1	4536845.71	9	474745.58	4536511.54	16	474427.09	4536785.41
4	474635.36	4536807.02	10	474658.29	4536577.3	17	474583.49	4536748.26
5	474649.08	4536842.31	11	474646.77	4536581.09	18	474594.79	4536756.54
6	474784.65	4536777.84	12	474582.15	4536535.84	19	474521.79	4536785.6
			13	474646.88	4536429.1	20	474420.31	4536797.54

Agim
Kojku



VENDIM
Nr. 273, datë 4.5.2023

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË
CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE EOLIKE DHE
VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK
ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË
TRAGJAS, NJËSIA ADMINISTRATIVE
ORIKUM, QARKU VLORË, NGA
SHOQËRIA “RENEW POWER
ALBANIA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë, nga shoqëria “RENEW POWER ALBANIA” sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria “RENEW POWER ALBANIA” sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal NIPT/NUIS: L52403002R;

c) Tipi centralit: Eolik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 3 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë: Koha për marrjen e lejes së ndërtimit, ndërtimin dhe vënien në operim të parkut eolik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në Tragjas, Njësia Administrative Orikum, qarku Vlorë;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në

përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) Shoqërisë “RENEW POWER ALBANIA” sh.p.k. i lind e drejta të krijojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit eolik;

gj) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike eolike dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 3 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, në Tragjas, njësia administrative Orikum, Qarku Vlorë, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë për qëllime të veçanta mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

h) Shoqëria “RENEW POWER ALBANIA” sh.p.k., ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht, çdo tre muaj, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ose institucioneve të tjera të autorizuar informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit eolik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “RENEW POWER ALBANIA” sh.p.k. ose shoqërisë për qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

**VENDIM****Nr. 274, datë 4.5.2023****PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË TJERA TË NDËRTESAVE QË PËRJASHTOEN NGA LIGJI NR. 116/2016, “PËR PERFORMANCËN E ENERGJISË NË NDËRTESA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 4, të ligjit nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e kategorive të tjera të ndërtesave dhe njësive të ndërtesave që do të jenë objekt përjashtimi prej detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.

2. Termat e përcaktuar në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

a) “Ndërtesa në formën e sallave të hapura”, sallat e sportit (basketboll dhe fusha tenisi, pishina, salla gjimnastike, pista vrapimi) sallat teatrale, cirqet, sallat e mbështjella me material plastmase, duke përfshirë dhe hapësirën për qëndrimin e spektatorëve;

b) “Ndërtesa ushtarake dhe të mbrojtjes”, magazinat ushtarake, si dhe kazernat për Forcat e Armatosura;

c) “Ndërtesat, njësi nëntokësore”, ndërtesat ose njësitë të cilat shfrytëzohen për qëllime të tilla, si ndërtesa për garazhe (tokësore dhe nëntokësore), parkime të mbuluara të automjeteve, qilarët, qilarë verërash;

ç) “Zona me kërkesa minimale të komfortit”, zonat ku përfshihen të gjitha aktivitetet e parashikuara sipas shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kategoritë e ndërtesave ose njësitë e ndërtesave, që përjashtohen nga detyrimi për të zbatuar kërkesat minimale për performancën e energjisë në ndërtesa dhe masat e tjera që rrjedhin nga ligji nr. 116/2016, janë:

a) ndërtesat, njësi nëntokësore, të cilat janë të destinuara për t’u përdorur për aktivitete sipas shkronjës “c”, të pikës 2, duke përjashtuar rastet kur njësitë nëntokësore përdoren si zona që duhet të plotësojnë kërkesat minimale të komfortit, sipas shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) ndërtesat ose njësitë nëntokësore me status ushtarak dhe civil të mbrojtjes (të Forcave të Armatosura dhe të mbrojtjes civile) dhe të institucioneve të tjera qendrore për rritjen e sigurisë publike, duke përfshirë ndërtesat që shërbejnë për qëllime stërvitjeje, poligone, tunele, bunkerë strehimi, magazinat ushtarake, për aq kohë sa ndërtesat ose njësitë e ndërtesës nuk përdoren si zona që duhet të plotësojnë kërkesat minimale të komfortit sipas shtojcës II të këtij vendimi;

c) ndërtesat e veçuara, të cilat nuk përdoren si zona që duhet të plotësojnë kërkesat minimale të komfortit sipas shtojcës II të këtij vendimi;

ç) magazinat ku mbahen mallra të ndryshme të cilat nuk kanë datë skadence. Magazinat, të cilat kanë në projekt ose kanë të vendosur impiant teknik për kondicionimin e ajrit, nuk klasifikohen në ndërtesat që përjashtohen nga ky vendim pavarësisht materialeve ose produkteve që do të magazinohen;

d) ndërtesat në formën e sallave të hapura, për aq kohë sa nuk përdoren si zona që duhet të plotësojnë kërkesat minimale të komfortit sipas shtojcës II të këtij vendimi.

dh) objektet që do të ndërtohen në zbatim të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, dhe ndërtimi i të cilave miratohet nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit.

4. Subjektet, që përfitojnë sipas pikës 3, të këtij vendimi, dorëzojnë pranë Agjencisë për Eficiencën e Energjisë deklaratën sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Agjencia për Eficiencën e Energjisë monitoron subjektet që përfitojnë, sipas pikës 3 të këtij vendimi, duke bërë auditimin energjetik të ndërtesës ose të njësisë së ndërtesës.

6. Vendimi nr. 122, datë 3.3.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kategorisë së ndërtesave, që përjashtohen nga ligji nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, shfuqizohet.



7. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia për Eficiencën e Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA I
FORMATI I DEKLARATËS

Subjekti: _____
NIPT/ID: _____
Celular: _____
Email: _____

**DEKLARATE PËR OBJEKTIN QË PËRJASHTOHET NGA DETYRIMET E
AUDITIMIT ENERGJETIK**

Unë deklarnesi _____, auditues energjie/pronari objektit/studio projektuese, deklaroj me vullnetin tim të lirë e të pakushtëzuar, nën përgjegjësinë time të plotë, se bazuar në ligjin nr. 116/2016, “Për performancën e energjisë së ndërtesave”, dhe VKM-në nr. (numri i kësaj VKM-je pas miratimit) “Për miratimin e kategorive të ndërtesave që përjashtohen nga performanca e energjisë së ndërtesave”, **“Objekti me emërtim** “(emërtimi që aplikohet për leje ndërtimi, zhvillimi, rikonstruksion ose shitje ose dbënie me qira) _____”, me **adresë:** rr. “_____”, Njësia Administrative _____, zona kadastrale _____, numër pasurie _____ Bashkia _____, qarku _____, me investitor/zhvillues “_____” sh.p.k., administrator z. _____, **përjashtohet nga procesi i vlerësimit të performancës së energjisë në ndërtesa dhe, si rrjedhojë, dhe nga detyrimet që vijnë si rrjedhojë e ligjit nr. 116/2016.**

SHTOJCA II
ZONA ME KËRKESA MINIMALE TË KOMFORTIT

1.1 Tipologjia: Ndërtesa banimi - Banesë e vetme familjare

Zona

Holl i banesës

Dhoma e fjetjes

Salloni

Tualeti

Kuzhina

Korridor i banesës

Banjë

Zonat e përbashkëta të qarkullimit

2.1 Tipologjia: Rezidenciale - Banesa në bllok apartamentesh

Zona

Holl i banesës

Dhoma e fjetjes

Salloni

Tualeti



Kuzhina

Korridor i banesës

Banjë

3.1 Tipologjia: Zyrat - private

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)

Tualeti

Recepcioni

Dhoma e pajisjeve të lehta

Zona e përgjithshme e zyrave

Suitë fitnesi/gjymnastike

Dhomat e zhveshjeve me dushe

Zona për përgatitjen e ushqimit

Zona e ushqimit/e pijeve

Punishte - repart punëtorie

Zyrat për menaxhimin e parkimit

3.2 Tipologjia: Zyrat - publike

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)

Tualeti

Recepcioni

Dhoma e pajisjeve të lehta

Zona e përgjithshme e zyrave

Suitë fitnesi/gjymnastike

Dhomat e zhveshjeve me dushe

Zona për përgatitjen e ushqimit

Zona e ushqimit/e pijeve

Punishte - repart punëtorie

Lavanderi

3.3 Tipologjia: Dyqane për shitje me pakicë

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët) - jo publike

Zona për përgatitjen e ushqimit

Zona e ushqimit/e pijeve

Dhoma e pajisjeve të lehta

Zona e shitjes me dyqane të vogla – e përgjithshme

Zona e shitjes me dyqane të vogla – e ftohur

Zona e shitjes me dyqane të vogla – elektrike

Tualeti

Zona e përgjithshme e zyrave

4.1 Tipologjia: Arsimi - shkollat, kolegje dhe universitete

Zona

Dhomat e zhveshjeve me dushe

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)

Palestra

Zona e ushqimit/e pijeve

Zona për përgatitjen e ushqimit



Holli/salla e ligjëratave/hapësirë e takimeve

Sallë e kompjuterëve

Laboratori

Dhoma e pajisjeve të lehta

Recepcioni

Pishinë

Tualeti

Punishte - repart punëtorie

Klasat e Mësimi

Zonat e zyrave dhe të administratës

Dhoma e fjetjes

Banjë

Dhomat e përbashkëta për student

Lavanderi

5.2 Tipologjia: Spitalet dhe shtëpitë e kujdesit

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët) - jo publike/e kufizuar

Tualeti

Recepcioni

Salla Post-Mortem

Zona e ushqimit/e pijeve

Zona për përgatitjen e ushqimit

Dhoma e pajisjeve të lehta

Studio terapeutike

Apartament për fjetje

Lavanderi

Zonat konsultim/trajtim 24-orësh

Zonat e grumbullimit/hollet

Salla pishinës për hidroterapi

Zona e proceseve industriale

Laboratori

Salla e operacionit

Dhomat e zhveshjeve me dushe

Klasa

Salla e incizimeve diagnostike

Banjë

Apartamente të përgjithshme

Zonat e zyrave dhe të administratës

5.3 Tipologjia: Qendra ditore për komunitetin

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)

Tualeti

Recepcioni

Palestra

Zona për përgatitjen e ushqimit

Zona e ushqimit/e pijeve

Dhoma e pajisjeve të lehta

Dhomat e zhveshjeve me dushe



Punishte - repart punëtorie
Holli/salla e ligjëratave/hapësirë e takimeve
Zonat e zyrave dhe të administratës

6.1 Tipologjia: Hotele

Zona

Zonat e grumbullimit/hollet
Dhomë hoteli, me banjë
Dhomat e zhveshjeve me dushe
Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)
Zona për përgatitjen e ushqimit
Zona e ushqimit/e pijeve
Suitë fitnesi/gjimnastike
Lavanderi
Dhoma e pajisjeve të lehta
Recepcioni
Tualeti
Pishinë
Palestra
Dyqan dhoma
Zona e përgjithshme e zyrave

6.2 Tipologjia: Restorant dhe kafenetë

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)
Zona e ushqimit/e pijeve
Zona për përgatitjen e ushqimit
Podiumi për performanca (skena)
Dhoma e pajisjeve të lehta
Tualeti
Zona e Përgjithshme e Zyrave

7.1 Tipologjia: Salla të mbyllura për argëtim, koncerte, takime etj.

Zona

Dhomat e zhveshjeve me dushe
Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)
Palestra
Zona e ushqimit/e pijeve
Studio fitnesi
Suitë fitnesi/gjimnastike
Zona për përgatitjen e ushqimit
Holli/salla e ligjëratave/hapësirë e takimeve
Auditoriumi
Patinazhi
Lavanderi
Zona e Performancës (skena)
Dhoma e pajisjeve të lehta
Zonat e qarkullimit publik
Recepcioni



Zona e shitjeve - e përgjithshme

Pishinë

Tualeti

Punishte - repart punëtorie

Zona e përgjithshme e zyrave

8.1 Tipologjia: Magazinat e zakonshme dhe magazinat frigoriferike

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)

Zona për përgatitjen e ushqimit

Zona e ushqimit/e pijeve

Dhoma e pajisjeve të lehta

Recepioni

Tualeti

Dhoma e zhveshjeve me dushe

Zona e përgjithshme e zyrave

Zona e ftohur për ruajtjen e produkteve

Zonat e zhvillimeve të proceseve përpunuese

Zonat e paketimit të produkteve

8.2 Tipologjia: Ndërtesat e përgjithshme industriale

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)

Zona e ushqimit/e pijeve

Zona për përgatitjen e ushqimit

Zona e proceseve industriale

Laboratori

Dhoma e pajisjeve të lehta

Recepioni

Tualeti

Zona e përgjithshme e zyrave

9.1 Tipologjia: Të tjera - Gjykatat

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)

Tualeti

Recepioni

Zona për përgatitjen e ushqimit

Holli/salla e ligjëratave/hapësirë e takimeve

Zona e ushqimit/e pijeve

Dhoma e pajisjeve të lehta

Qeli (polici/ burg)

Zona e përgjithshme e zyrave

9.4 Tipologjia: Ndërtesa për qëllime riedukimi dhe për shlyerje dënimi

Zona

Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët)

Tualeti

Recepioni



Dhomat e zhveshjeve me dushe
Zona për përgatitjen e ushqimit
Palestra
Zona e ushqimit/e pijeve
Dhoma e pajisjeve të lehta
Qeli (polici/ burg)
Dhoma e fjetjes
Banjë
Suitë fitnesi/gjmnastike
Zona e përgjithshme e zyrave
Muze dhe biblioteka
Zona e qarkullimit (korridoret dhe shkallët) - jo publike
Tualeti
Recepcioni
Zona për përgatitjen e ushqimit
Holli/salla e ligjëratave/hapësirë e takimeve
Laboratori
Zona e ushqimit/e pijeve
Dhoma e pajisjeve të lehta
Hapësirat publike dhe me vitrina
Zona e përgjithshme e zyrave
Punishte - repart punëtorie

VENDIM**Nr. 275, datë 4.5.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI
I RRUGËS ‘TASI DËMA’, FIER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës ‘Tasi Dëma’, Fier”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 3 052 210 (tre milionë e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 052 210 (tre milionë e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e dhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Fier.

8. Bashkia Fier kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.



9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Fier për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes

së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Fier për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE TË PASURISË TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS ‘TASI DËMA’, FIER”

Nr.	Pronari	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Të dhënat për shpronësim				Shënime
Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e truallit (m ²) gjithsej	Sip. e truallit që shpronësohet (m ²)	Çmimi i truallit (m ²)	Vlera e truallit (lek)	Vlera totale	Konfirmimi ASHK Fier
1	Artan Isufaj, Rubin Isufaj, Sokol Isufaj, Kimete Isufaj	8531	13/484	Truall	819	245	12458	3,052,210	3,052,210	Konfirmuar nga ASHK-ja Me certifikatë pronësie
Vlera totale									3,052,210	

VENDIM

Nr. 276, datë 4.5.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 587, DATË 22.7.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË
BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) TË
DËMTUARA, NË ZONAT E REJA PËR
ZHVILLIM DHE RINDËRTIM NË TË
NJËJTIN TRUALL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe

ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Numërtimi i pikës 5 ndryshohet dhe bëhet “pika 6”;

b) Numërtimi i pikës 6 ndryshohet dhe bëhet “pika 7”;

c) Pas pikës 4.1, shtohen pikat 5 dhe 5.1, me këtë përmbajtje:

“5. Përdorimin e fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2023 nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

5.1. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit



06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 1 500 000 000 (një miliard e pesëqind milionë) lekësh pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 277, datë 4.5.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.2, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.3, me këtë përmbajtje:

“2.3 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2023, të jetë në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë pa TVSH, i cili i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 278, datë 4.5.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2.4, me këtë përmbajtje:

“2.4 Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2023, do të jetë në masën 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, pa TVSH, i cili do të shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, për



financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 279, datë 4.5.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 441, DATË 3.6.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË
BUXHETIN E VITIT 2020, PËR
FINANCIMIN E HARTIMIT TË
PROJEKTEVE PËR MIRATIMIN E
LEJEVE TË NDËRTIMIT, PËR
NDËRTIMIN E NJËSIVE TË BANIMIT
NË NDËRTESA (PALLAT), NË ZONAT E
SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË
DETYRUAR, NË BASHKITË DURRES,
KAVAJË, KAMZË, MIRDITË, KRUIJË,
KURBIN, LEZHË, SHIJAK DHE VORË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, të neneve 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titullin e vendimit hiqen fjalët “... miratuar në buxhetin e vitit 2020 ...”;

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.1 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2023, për financimin e hartimit të projektit për miratimin e lejeve të ndërtimit, përfshirë kostot për shërbime të rëlvimeve topografike, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të shërbimeve gjeologjike, që i takojnë nëntokës e punimeve në themel, për ndërtimin e njërive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë, në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë pa TVSH;

2.2 Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i kalohet fondi në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projekteve, sipas përcaktimeve të pikës 2.1, të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM

Nr. 280, datë 4.5.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 307, DATË 16.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT DHE NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 307, datë 16.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 3.3 shtohet pika 3.4, me këtë përmbajtje:

“3.4. Përdorimi i fondit të miratuar në buxhetin e vitit 2023, në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë pa TVSH, i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin ‘Shpenzime kapitale me financim të brendshëm’, të programit 06210 ‘Programe zhvillimi për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë?’.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM

Nr. 281, datë 4.5.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 543, DATË 17.7.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË PASURISË NR. 1/644, ZONA KADASTRALE NR. 8210, TIRANË, NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA BASHKIA TIRANË TEK MINISTRIA E DREJTËSISË, TË PASURISË NR. 5/626, ZONA KADASTRALE NR. 8160, TIRANË, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 670, DATË 7.8.2013, DHE NR. 219, DATË 21.3.2017”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Plan-vendosja e sipërfaqes prej 4 900 (katër mijë e nëntëqind) m², pjesë e pasurisë nr. 5/626, në zonën kadastrale 8160, me emërtimin “truell”, me vendndodhje në Qytetin Studenti, Tiranë, që i bashkëlidhet vendimit nr. 543, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me plan-vendosjen, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI REP. SHQIPERISE – NE ADMINISTRIM TE MIN. DREJTESISE DATE 11/04/23 QELIMI REGJISTRIM

VENDNDODHJA: BASHKIA E DIBRES DVASHK/ZVASHK: ASH ZONA KADASTRALE: 8160 HARRI I PABURSE (GJENDJE): INDeksi HARTES: 5-14

TE DHENAT E PABURISE: LLOZI I PABURISE: TIRALLI SP. PABURISE: 1000 m² SPOFIZAGE GJERMES HEDHITIMI: m² HARRI I KATIEVE: HARRI I POREVE:

KORNIZA REFEREUERE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X,Y

SH 1:2500

X,Y

SHPJEGUES

RIPOZICIONIM I PRONES

KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE SPOFIZAGE = 1000 m²

KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE SPOFIZAGE = 1000 m²

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1				5/637		
2				5/637		
3				5/637		
....				5/637		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: EDMOND NDOJ

LICENSA: NR. 1299 DATE 12.06.2018

KOMPANIA:

NIPT: 191519052A

NENSHKRIMI/VULA: *[Signature]*

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI:

DVASHK:

NENSHKRIMI:

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI:

NENSHKRIMI/VULA:

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-Gps; S-Stacion total; D-Matje Distancoash

PERCAKTIMI I KUFIRIT:

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronareve; K-Kufitorët të Gjithë; KP-Kufitorët Pjesërisht

PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

REPUBLIKA E SHQIPERISE – NE ADMINISTRIM TE MINISTRISE SE DREJTESISE

MINISTRI ULSI MANJA

NENSHKRIMI: *[Signature]*

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-Gps; S-Stacion total; D-Matje Distancoash; P-Përfaqësues i Pronareve; K-Kufitorët të Gjithë; KP-Kufitorët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;



VENDIM

Nr. 282, datë 4.5.2023

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 422, DATË 6.5.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRBËRJEN, RREGULLAT E
FUNKSIONIMIT DHE TRAJTIMIN
FINANCIAR TË GRUPIT NEGOCIATOR
DHE DETYRAT E KRYENEGOCIATORIT
PËR ZHVILLIMIN E NEGOCIATAVE TË
ADERIMIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË BASHKIMIN
EVROPIAN”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të vendimit nr. 749, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, me propozimin e ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në nënndarjen “- Z. Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm, dhe z. Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm, bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 24”, fjalët “... dhe z. Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm, bashkënegociator përgjegjës ...” zëvendësohen me “... negociator përgjegjës ...”;

b) Nënndarja “- Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kriterin ekonomik dhe kapitujt 4, 32 dhe 33” zëvendësohet me “- Znj. Adela Xhemali, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kriterin ekonomik, kapitujt 32 dhe 33”;

c) Nënndarja “- Z. Besart Kadia, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 1, 2, 3, 6, 7, 20 dhe 30, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitujt 19 e 28” zëvendësohet me “- Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitujt 1, 3, 6, 7, 20 dhe 30, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 4 dhe 28.”;

ç) Fjalët “Znj. Ermira Gjeçi ...” zëvendësohen me “Z. Arian Jaupllari ...”;

d) Fjalët “Znj. Ornela Çuçi ...” zëvendësohen me “Znj. Almira Xhembulla ...”;

e) Në fund të nënndarjes “- Znj. Natasha Ahmetaj, zëvendës guvernator i dytë në Bankën e Shqipërisë, negociator përgjegjës për kapitullin 17”, shtohen fjalët “... dhe bashkënegociator për kapitullin 4”;

f) Në fund shtohet nënndarja “- Znj. Olta Manjani, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, negociator përgjegjës për kapitullin 2, si dhe bashkënegociator përgjegjës për kapitullin 19.”;

2. Ngarkohen ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe grupi negociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë